



# ORGANIZATA LIBURNETIK

## STATUTI

### NENI 1 FORMA E ORGANIZIMIT

Organizata “LIBURNETIK”, është **Shoqatë**, në kuptimin e nenit 39 të Kodit Civil, Jo Fitimprurëse, Jo Qeveritare dhe me anëtarësi. Është krijuar me vullnet të lirë dhe të plotë të themeluesve të saj. Në zhvillimin e aktivitetit të saj, “LIBURNETIK” do të bazohet në dispozitat ligjore në fuqi, të sipërpërmendura, për organizatat Jo Fitimprurëse me anëtarësi. Organizata Jo Fitimprurëse “LIBURNETIK” gëzon liri dhe autonomi veprimi në përputhje me Statutin, me Aktin e Themelimit dhe me Programin e saj.

Themelimi i organizatës “LIBURNETIK” ka për qëllim ndërgjegjësimin, promovimin dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare, përmirësimin e jetës sociale përmes zbatimit të projekteve dhe të aksioneve që do të ndërmerren, bazuar në planin e saj strategjik. Në veprimtarinë e saj, Organizata do të reflektojë vullnetin e mirë të njerëzve për të jetuar në një shoqëri të shëndoshë e me vlera.

### NENI 2 EMËRTIMI DHE VULA

Organizata ka emrin dhe vulën e saj, të cilat do shoqërojnë të gjithë dokumentacionin dhe publikimet e saj.

Organizata vepron nën emrin: “**Organizata LIBURNETIK**”.

Përveç emërimit në gjuhën shqipe, Organizata do të përdorë edhe emërtimin në gjuhën angleze: “**LIBURNETIK non-profit organisation / non governmental organisation**”. Emërtimi i shkurtuar i organizatës në gjuhën angleze do të jetë: “**LIBURNETIK NPO**” ose “**LIBURNETIK NGO**”.

Organizata ka vulën e saj me mbishkrimin “Organizata LIBURNETIK” ose/edhe “LIBURNETIK NGO”. Vula ka formë të rrumbullakët.

### NENI 3 THEMELIMI

Organizata themelohet nga persona fizikë. Anëtarët themelues të Organizatës janë personat fizikë të poshtë shënuar:



1. **KRESHNIK LAKO** i biri i Fatmirit i datëlindjes 16/07/1984 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I40716063S;
2. **IBRAHIM MUSTAJ** i biri i Zeniut i datëlindjes 25.04.1992 lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë identifikuar me anë të numrit personal J20425089A;
3. **ERGYS GEZKA** i biri i Arbenit i datëlindjes 25.07.1985 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I50725060R;
4. **ERVIN ÇELA** i biri i Naimit i datëlindjes 04/01/1987 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I70104044G;
5. **OREST SHYTI** i biri i Kristaqit i datëlindjes 24/02/1993 lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal J30224101O;
6. **IRENA LOLI** e bija e Nikos, e datëlindjes 09.09.1990 lindur në Durrës dhe banuese në Durrës, identifikuar me anë të numrit personal J05909067F;
7. **NERTILA XHIVESHI** e bija e Elmiut, e datëlindjes 25.05.1989 lindur në Peshkopi dhe banuese në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I95525087D;
8. **MALVIN URUÇI** i biri i Asllanit i datëlindjes 16.06.1989 lindur në Durrës dhe banues në Durrës identifikuar me anë të numrit personal I90616085E.

#### **NENI 4 BAZA LIGJORE**

Organizata themelohet mbështetur në Legjislacionin Shqiptar.

Organizata është person juridik shqiptar.

Organizata ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi: neni 39 – 53/1 i Kodit Civil, ligji 8788, datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jo Fitimprurëse”, ligji 8789, datë 07/05/2001 “Për regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”, si dhe në bazë të statutit të vet që reflekton qëllimet dhe programin e themeluesve të saj.

#### **NENI 5 SELIA E ORGANIZATËS DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË**

Organizata ka selinë e saj ligjore në Tiranë në adresën: **Rruga e Barrikadave 260/1, Tiranë, Kodi postar 1001.**

Veprimtaria e Organizatës do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rast bashkëpunimi edhe më gjerë.

Organizata është e gatshme të krijojë degë të saja dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera që kanë objekt të ngjashëm veprimtarie, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera.



Organizata shpreh interesin e vetë të zgjerojë hapësirat e veprimtarisë, të vendosë lidhje dhe bashkëpunim me organizata të ngjashme.

## **NENI 6**

### **QËLLIMI DHE FUSHAT E VEPRIMTARISË**

Organizata LIBURNETIK vë bazat mbi themelet e të drejtave të njeriut, mbi respektimin e të gjitha normave ligjore të Kushtetutës dhe të ligjeve shqiptare, mbi respektimin e konventave

ndërkombëtare, direktivave dhe ligjeve të Bashkimit European në lidhje me të drejtat dhe detyrat e çdo individi. Themelimi i Organizatës LIBURNETIK ka për qëllim sensibilizimin, promovimin dhe\*

---

\*Ndryshuar me vendimin gjyqësor Nr.3929/1 datë 24/02/2016

zhvillimin e shoqërisë shqiptare, përmirësimin e jetës sociale, përmes zbatimit të projekteve dhe të aksioneve që do të ndërmerren, bazuar në objektivat e parashikuara nga statuti dhe nga plani i saj strategjik.

Organizata përmbush të gjitha kriteret për të qenë degë e organizatës “ASAL Student” që vepron në territorin italian dhe european dhe themelohet pikërisht nga vullneti i disa prej themeluesve të kësaj organizate. Organizata LIBURNETIK do veprojë në territorin shqiptar si degë e organizatës ASAL Student dhe e pavarur.

Organizata LIBURNETIK krijon raporte me institucionet dhe aktorë të territorit ku vepron për arritjen e qëllimeve të saj sociale, në veçanti duke bashkëpunuar me autoritetet lokale, përfshirë këtu edhe lidhjet sipas marrëveshjeve përkatëse me organizata të tjera dhe me kompani që kanë qëllime të ngjashme apo të lidhura me të.

Organizata mundet, që vetëm për qëllime vetëfinancimi dhe jo fitimprurëse, të ushtrojë veprimtari marginale (tregtare) sipas legjislacionit në fuqi. Nuk do të ndjekë qëllime politike apo ekonomike. Ajo është Organizatë Jo Fitimprurëse dhe Jo Qeveritare.

Në mënyrë më specifike për përmbushjen e qëllimit, organizata ka si objektiva:

- Planifikimin dhe zbatimin e projekteve/iniciativave kombëtare dhe europiane duke punuar me metodologji multikulturore, me qëllim rritjen e solidaritetit, shkëmbimit dhe integritit mes individëve, popujve të ndryshëm dhe nxitjen e qeverisjes së mirë dhe të reformave të integritit në BE;
- Promovimin, programimin dhe ndërtimin e një sektori ndërmjetësimi social, kulturor e ligjor;



- Vënie në dispozicion të eksperiencës së organizatës si ndërmjetëse në lidhje me bashkëpunimin dhe dialogun mes institucioneve shqiptare dhe të huaja për ndërtimin dhe kontribuimin e një legjislacioni të njëzuar për emigracionin;
- Nxitjen e të drejtave të njeriut, legalitetit dhe shtetit të së drejtës;
- Orientim dhe ofrim shërbimesh ligjore nëpërmjet këshillimit, trajtimit dhe përfaqësimit përpara organeve kompetente;
- Promovimin e të drejtave civile, të interesave të përbashkëta dhe orientim ligjor për ish emigrantë (shqiptarët që kthehen nga emigracioni), re-integrimin e tyre në territorin shqiptar, të kulturës së reciprocitetit, dialogut me kulturat dhe traditat rajonale, rritjen e bashkëpunimit kulturor dhe ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve përkatëse nga të cilat ata kthehen;
- Kryerjen e të gjitha veprimtarive të përmendura edhe në favor të ish emigrantëve apo të individëve shqiptarë që kthehen nga emigracioni;
- Inkurajimin dhe forcimin e iniciativave dhe shërbimeve në lidhje me aktivitete artistiko-kulturore, turistike dhe mjedisore;
- Mbrojtjen dhe promovimin e të gjitha kulturave të pranishme në Shqipëri dhe më gjerë nëpërmjet artit dhe trashëgimisë kulturore, reflektimeve produktive, sociale dhe ekonomike;
- Punë kërkimore dhe publikime shkencore;
- Zbatimin e një programi për zhvillimin e arsimit jo formal, duke pasur si qëllim formimin e të rinjve;
  
- Rritjen e përfshirjes së rolit të të rinjve në shërbimet arsimore dhe shëndetësore;
- Shkrim dhe shtypje botimesh informuese dhe orientuese si: materiale për konferenca, buletinë si dhe krijimin e mundshëm të një radioje apo të ndonjë programi televiziv me tematika sociale, dokumentarë etj.;
- Përpilimin dhe publikimin e studimeve, kryerjen e sondazheve dhe pyetësorëve për të evidentuar qasjet që targetgrupet e ndryshme kanë ndaj temave sociale, kulturore dhe ekonomike;
  
- Të organizojë aktivitete multikulturore në biblioteka, ekspozita, konferenca, seminare, debate, grupe pune dhe publikime: si gazeta, revista, blogje, platforma ëeb etj.;
- Promovimin e fushatave ndërgjegjësuese kundër racizmit dhe diskriminimit, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin me median;
- Rritjen e mundësive integruese dhe ndërvepruese për Romët;
- Veprimtari në zhvillimin e kurseve, trajnimeve teorike/praktike për edukatorë, mësues, psikologë, punonjës socialë, qytetarë/vullnetarë etj.;
- Dhënien e shërbimeve dhe realizimin e aktiviteteve psiko-sociale, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e gjëndjes emocionale dhe që kanë impakt pozitiv në shoqëri;
- Punë orientuese dhe aktivitete sociale me target grupe në rrezik/të marginalizuara;
- Dhënien e ndihmesës për përmirësimin e statusit të gruas në shoqëri dhe punë konstante për luftën ndaj diskriminimit gjinor;



- Dhënien e kontributit për fuqizimin e shoqërisë civile dhe advokimin për procesin e decentralizimit të saj;
- Krijimin e një qasjeje të re, një ure, midis pjesës teorike dhe asaj praktike për të rinjtë, duke ofruar një orientim drejt botës akademike dhe tregut të punës;
- Krijimin e një sipërmarrjeje sociale apo të një biznesi social;
- Ndërmarrjen e projekteve inovative në sektorin e bujqësisë dhe promovimin e produkteve shqiptare;
- Trajnimin dhe promovimin për profesionet në zhdukje (ndërtuesit e shtëpive karakteristike si kulla, llozha) profesione artizanale (pirografi, punime druri, guri) etj.;
- Përmirësimi i kultures mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore përmes veprimtarisë së riciklimit;
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë/ndërmarrja e nismave për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit dhe kafshëve;
- Bashkëpunim, pjesëmarrje dhe aderim në organe publike ose private, kombëtare dhe ndërkombetare, në partneritet me organizatat, lëvizjet, qendrat dhe fondacionet, që kanë qëllime të ngjashme ose analoge me ato të Organizatës LIBURNETIK;
- Ndihmesën për përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje;
- Dhënien e kontributit në aspektet e mësipërme për progresin e Shqipërisë drejt interimit në Bashkimin Europian.\*

## **NENI7 NDALIMI I SHPËRNDARJES SË FITIMEVE**

Organizata përdor pasuritë e vetavetëm në përputhje me qëllimin dhe objektivat e përcaktuara nga ky Statut dhe nga Legjislacioni shqiptar.

*\*Ndryshuar me vendimin gjyqësor Nr.3929/1 datë 24/02/2016*

“LIBURNETIK” është Organizatë JoFitimprurëse së cilës i ndalohet shpërndarja e përfitimit financiar nga të ardhurat e saj anëtarëve të Bordit Drejtues, Bordit Mbykqyrës apo themeluesve të saj.

Midis “LIBURNETIK” dhe çdonjërit prej anëtarëve të Bordit Drejtues, Bordit Mbykqyrës apo themeluesve të saj mund të lidhen marrëveshje financiare vetëm nëse gjykohet e leverdisshme për organizatën dhe me vendim të Bordit Drejtues.

Për punën dhe shpenzimet e kryera në interes e me porosi të Organizatës përcaktohen nga Presidentipaga, shpërblime apo kompensime të tjera.

Organizata, në përputhje me planin e vet të punës dhe buxhetin, mund të jetë donatore dhe/ose bashkëdonatore në projekte të miratuara nga Bordi Drejtues.



## **NENI8 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Organizatës Jo Fitimprirëse “LIBURNETIK” është e pakufizuar.

## **NENI 9 ORGANET DREJTUESE DHE KOMPETENCAT E TYRE**

Organet drejtuese të Organizatës janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
2. Bordi Drejtues;
3. Drejtori Ekzekutiv;

Në organet drejtuese mund të zgjidhen vetëm Anëtarët e Plotë.

### **1. Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendim-marrës i Organizatës dhe nuk mund të ketë më pak se 5 (pesë) anëtarë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së Anëtarëve të plotë të saj.

Asambleja e Përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e Përgjithshme e zakonshme mbahet një herë në vit, si rregull në Qershor.

Asambleja e Përgjithshme e zakonshme lajmërohet me shkrim të pakten 14 ditë më parë.

Vendimin për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të përvitshme e merr Bordi Drejtues. Nëse Bordi Drejtues nuk e bën këtë deri më 31 Maj, vendimi mund të merret nga Drejtori Ekzekutiv i Organizatës brenda 15 ditëve.

Drejtori Ekzekutiv i Organizatës drejton mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe në mungesë të tij mbledhja e Asamblesë drejtohet nga zv/Drejtori Ekzekutiv, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë Statut.

Protokolli i Asamblesë së Përgjithshme firmoset nga mbajtësi i protokollit dhe drejtuesi i Asamblesë së radhës dhe është i disponueshëm për publikun.

Nëse në orën e caktuar janë të pranishëm më pak se 1/2 e Anëtarëve të Plotë, Asambleja e Përgjithshme do të fillojë me 1 orë vonesë. Në rast se pas 1 ore pritjeje janë të pranishëm më shumë se 1/3 e Anëtarëve të Plotë, Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet dhe të marrë vendime të vlefshme.



Nëse edhe pas 1 ore pritjeje, janë të pranishëm më pak se 1/3 e Anëtarëve të Plotë, Asambleja e Përgjithshme merr vendimin e shtyrjes së saj në një datë tjetër brenda 30 ditëve.

Në seancën e shtyrë, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm 1/3 e Anëtarëve të Plotë. Nëse ky numer nuk arrihet edhe pas 1 ore pritjeje Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me numrin e Anëtarëve të Plotë që janë të pranishëm.

### **1.1.Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme merr vendime mbi:

- Themelimin;
- Shpërndarjen;
- Bashkimin ose përzierjen e Organizatës në një organizatë të një forme tjetër me shumicën e Anëtarëve: 2/3 e Anëtarëve;
- Harton Statutin e Organizatës, bën ndryshime në nenet përkatëse të Statutit dhe akteve që rregullojnë veprimtarinë e Organizatës;
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së Organizatës, mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- Zgjedh dhe emëron Drejtorin Ekzekutiv të Organizatës, Anëtarët e Bordit Drejtues si dhe përcakton detyrat e tyre;
- Miraton raportin vjetor të Bordit Drejtues;
- Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Organizatës dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm, përcakton buxhetin vjetor dhe miraton pasqyrat financiare;
- Miraton planin strategjik dhe programin për vitin pasardhës;
- Vendos mbi pranimin dhe përjashtimin e Anëtarëve;
  
- Përcakton shumën e kuotave të anëtarësisë;
- Zgjedh përfaqësuesin e Organizatës dhe përcakton detyrat e tij;
- Vendos për anëtarësimin e Organizatës në Organizata dhe organizma të tjerë;
- Merr vendime të tjera që lidhen me arritjen e objektivave të Organizatës;
- Krijon komitete të posatshme si dhe vendos për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në Statut;
- Miraton aktivitete për mbledhje fondesh, sipas nenit 37 të ligjit “Për Organizatat Jo Fitimprurëse”;
- Emëron likujduesit;
- Shqyrton raportin e likujduesve.

### **1.2 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**



Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme mund të thirret nga Bordi Drejtues, ose të paktën nga 1/5-ta e numrit të përgjithshëm të Anëtarëve të Plotë, por sidoqoftë nga jo me pak se 5 (pesë) Anëtarë të Plotë.

Në përputhje me kriteret e paragrafit 1 më sipër, Anëtarët e Plotë paraqesin propozimin për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme sëbashku me rendin e ditës i cili nuk mund të ndryshohet. Me marrjen e kërkesës për Mbledhje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, Bordi Drejtues duhet të caktojë mbajtjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme brenda 15

(pesëmbëdhjetë) ditëve. Nëse Bordi Drejtues nuk e bën këtë, Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme mund të mbledhet në përputhje me paragrafin 1 (një) të këtij neni, direkt nga Anëtarët e Plotë që kanë bërë kërkesën për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme.

Njoftimet për Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhen dërguar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së mbajtjes së saj.

## **2. Bordi Drejtues**

Bordi Drejtues përbëhet 5 (pesë) anëtarë .

Është Asambleja e Përgjithshme që zgjedh Kryetarin e Bordit Drejtues, zëvendësin e tij dhe tre anëtarët për një afat 3 (tre) vjeçar.

### **2.1 Kompetencat e Bordit Drejtues**

Mbledhjet e Bordit Drejtues zhvillohen sipas nevojës.

Mbledhjet e Bordi Drejtues thirren nga Kryetari i Bordit, çdo anëtar i tij dhe sipas rastit nga Drejtori Ekzekutiv ose nga zëvendësi i tij.

Bordi Drejtues merr vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm të paktën 3 (tre) Anëtarë të tij.

- Vendimet merren me shumicë të thjeshtë;
- Nëse 1 (një) anëtar i Bordit Drejtues nuk merr pjesë në 3 (tre) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit Drejtues, pa justifikim, për një periudhë jo më të shkurtër se 1 (një) vit, ai nuk do të jetë më anëtar i Bordit Drejtues dhe ky i fundit emëron një anëtar të ri deri në Asamblenë e Përgjithshme të radhës, ku konfirmohet anëtari i zgjedhur nga Bordi Drejtues ose zgjidhet një anëtar tjetër;
- Procedurat e treguara në pikën 2 të këtij neni nuk mund të zbatohen për më shumë se 2 (dy) anëtarë të Bordit Drejtues. Në këtë rast duhet zgjedhur një Bord Drejtues i ri.
- Mbaj në proces-verbalin në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Drejtues të Shoqatës;
- Mbajnë librin e vendimeve, urdhërave dhe udhëzimeve;
- Mban regjistrin e anëtarëve si edhe çdo dokumentacion tjetërtë parashikuar në Statut apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.





Bordi Drejtues i Organizatës përgatit programin e punës dhe raportin vjetor dhe ja paraqet këtë Asamblesë së Përgjithshme. Bordi Drejtues zbaton vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, ngrë komisione dhe vendos mbi çështje të veprimtarisë së Organizatës përveç atyre që janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

### **3. Drejtori Ekzekutiv**

Organi ekzekutiv i Organizatës dhe Përfaqësues ligjor i saj është Drejtori Ekzekutiv. Nëse për arsye të ndryshme nuk është i disponueshem, ja kalon këtë të drejtë zv/Drejtorit Ekzekutiv.

Drejtori Ekzekutiv dhe zv/Drejtori Ekzekutiv zgjidhen nga Bordi Drejtues dhe mandati i tyre zgjat 3 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

#### **3.1 Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv**

Drejtori Ekzekutiv i Organizatës ka këto kompetenca gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij:

- Administron veprimtaritë e përditshme të Organizatës, në zbatim të Statutit, vendimeve të Bordit Drejtues dhe Legjislacionit në fuqi;
- Përfaqëson Organizatën me palët e treta në përputhje me vendimet e Bordit Drejtues, nenet e Statutit dhe legjislacionin në fuqi;
- Raporton dhe jep llogari përpara Bordit Drejtues sa herë që i kërkohet;
- Lidh kontratat e punës me stafin e Organizatës, duke përdorur metodën e konkurimit të hapur e të lirë, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi Drejtues;
- Hyn në marrëdhënie me organizma të tjera vendase dhe të huaja;
- Mban kontakte dhe raporton sipas rastit në Drejtorinë e Pastrimit dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Në rast se Drejtori Ekzekutiv i Organizatës nuk mund të kryejë detyrën e tij, atë e zëvendëson zv/Drejtori Ekzekutiv me kompetenca të plota që Statuti i cakton Drejtorit Ekzekutiv.

4. Miratimi i ndryshimit të emërtesës së Nenit 10, e cila bëhet: Organet e Para Drejtuese

5. Miratimi i ndryshimit të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe emërimi i përfaqësuesit të ri ligjor të Shoqatës në rolin e Drejtorit Ekzekutiv dhe emërimi i Zv/Drejtorit Ekzekutiv.

#### **Anëtarët e rinj të Bordit Drejtues janë:**

- Ergys Gezka – Kryetar bordi, i biri i Arbenit i datëlindjes 25.07.1985 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I50725060R;
- Ibrahim Mustafaj – zv/Kryetar bordi, i biri i Zeniut i datëlindjes 25.04.1992 lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë identifikuar me anë të numrit personal J20425089A;



- Kreshnik Lako – anëtar bordi, i biri i Fatmirit i datëlindjes 16/07/1984 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I40716063S;
- Malvin Uruçi- i biri i Asllanit i datëlindjes 16.06.1989 lindur në Durrës dhe banues në Durrës identifikuar me anë të numrit personal I90616085E
- Klajdi Qehaja – anëtare bordi, i biri i Sulejmanit i datëlindjes 29.10.1992 lindur në Tirane dhe banuese në Tirane, identifikuar me anë të numrit personal J21029050J.

**Drejtori Ekzekutiv dhe Zv/Drejtori Ekzekutiv emërohen:**

- Drejtor Ekzekutiv - Lorela Musta, e bija e Xhemilit e datëlindjes 08.05.1991 lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal J15508002W;
- Zv/Drejtor Ekzekutiv –Nertila Xhiveshi e bija e Elmiut, e datëlindjes 25.05.1989 lindur në Peshkopi dhe banuese në Tiranë, identifikuar me anë të numrit personal I95525087D; \*

---

\*Ndryshuar me vendimin gjyqësor Nr.3929/1 datë 24/02/2016

**NENI 10  
ORGANET E PARA DREJTUESE,  
ZGJEDHJA DHE NDRYSHIMI I TYRE**

Në mbledhjen themeluese u zgjodhën organet e parashikuara:

**Bordi Drejtues**

- Ergys Gezka - President
- Ibrahim Mustafaj - zv/President;
- Nertila Xhiveshi - Sekretare;
- Ervin Çela - Anëtar;
- Orest Shyti - Anëtar.

**Bordi Mbikqyrës**

- Irena Loli - Kryetare;
- Malvin Uruçi - Anëtar;
- Kreshnik Lako -Anëtar.

**NENI11  
VENDIM-MARRJA DHE KOORDINIMI I PUNËS**



Koordinimin e veprimtarisë së Organizatës e realizojnë organet drejtuese të saja në përputhje me kompetencat e paracaktuara në këtë statut. Në veprimtarinë e Organizatës gjëjnë zbatim Statuti i saj, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Drejtues. Vendimet në Bordin Drejtues merren me shumicë të thjeshtë votash.

## **NENI 12 PËRFAQËSIMI I ORGANIZATËS**

Përfaqësues ligjor i Organizatës është Presidenti isaj. Nëse për arsye të ndryshme nuk është i disponueshem, ja kalon këtë të drejtë zv/Presidentit, me anë të një autorizimi, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

## **NENI 13 BURIMET E FINANCIMIT**

Burimet financiare dhe materialet e Organizatës janë:

- Kuota e Anëtarësisë, për shumën e të cilës vendos Bordi Drejtues me vendim të veçantë;
- Donacione të anëtarëve apo të personave të tjerë fizikë ose juridikë;
- Grante dhe Financime të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas ose të huaja, të organizatave/institucioneve apo agjensive të njohura nga ligji;
- Të ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas miratimit të Bordit Drejtues;
- Të ardhura nga pasuritë në pronësi të Organizatës.

Organizata mund të mbledhë fonde nëpërmjet, kontributeve, donacioneve, nga të ardhura të përftuara nga aktivitetet publike, organizimi i seminarëve, konferencave dhe burimeve të tjera financuese, shprehimisht të lejuara prej ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

## **NENI 14 ADMINISTRIMI I PASURIVE**

Organizata Jo Fitimprurëse “LIBURNETIK” i përdor pasuritë e veta vetëm në përputhje me qëllimin dhe objektivat e përcaktuara nga ky Statut.



Asambleja e Përgjithshme është organi kompetent për miratimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programeve të veçanta. Presidenti përgjigjet për menaxhimin e burimeve financiare dhe administrimin e tyre në përputhje me vendimet e marra nga mbledhja e Asamblesës së Përgjithshme.

Në koordinim me donatorët, Presidenti përcakton vlerën e pagesave për punën e Drejtuesve të projekteve, të koordinatorëve dhe aktivistëve.

Pagat, rimbursimet, shpenzimet për stafin e Organizatës si dhe shpërblimet e mundshme i përcakton Presidenti.

Veprimtaria financiare e organizatës realizohet kryesisht nëpërmjet sistemit bankar. Organizata ka llogarinë e saj bankare që hapet dhe mbyllet sipas urdhërave të Bordit Drejtues.

Bordi i Drejtuesve dhe donatorët e mundshëm kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjëndjes financiare të Organizatës dhe Bordi i Drejtuesve me stafin e tij i japin ato brenda një afati optimal, nëse është e nevojshme, i shoqërojnë ato shpjegime me fotokopjet e dokumentacionit përkatës.

Veprimet financiare të Organizatës kryhen sipas rregullave të vendosura me ligj.

Bordi Drejtues i Organizatës autorizohet të organizojë dhe të kryejë veprimet financiare.

## **NENI 15 NDRYSHIMET NË STATUT**

Ndryshimet në Statut mund të propozohen nga 1/2 e Asamblesës së Përgjithshme, Drejtori Ekzekutiv ose nga Bordi Drejtues.

Ndryshimet në Statutin e Organizatës bëhen vetëm nga Asambleja e Përgjithshme, ku duhet të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Asamblesës së Përgjithshme.

Ndryshimet në Statut bëhen me votimin pro të jo më pak se 2/3 të pjesëmarrësve në mbledhje.

## **NENI 16 MIRATIMI I RREGULLAVE TË BRENDSHME**

Rregulloret e brendshme të Shoqatës dhe degëve të saj, ku përcaktohen normat e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të Shoqatës, raportet me të tretët etj, hartohen nga stafi në përputhje të Statutit dhe Aktit të themelimit dhe miratohen nga Bordi Drejtues.

## **NENI 17 ANËTARËSIMI**



Anëtarësimi në Organizatë është vullnetar.

Organizata ka disa forma anëtarësimi:

1. Anëtarë të Plotë;
2. Anëtarë Mbështetës;
3. Anëtarë Nderi.

## **1. Anëtar i Plotë**

Anëtar i Plotë i Organizatës mund të jetë kushdo që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Pranon Statutin e Organizatës;
- Është aktiv prej 6 (gjashtë) muajsh.

Mbledhja e Përgjithshme mund të përcaktojë në një moment të dytë kriteret më të ngushta për dhënien e anëtarësimi të plotë.

### **1.1 Kriteret**

Lista e anëtarëve të plotë që janë themeluesit e Organizatës do të konfirmohet në Asambleen e parë të Përgjithshme.

Me marrjen e kërkesës së një personi që dëshiron të jetë anëtar i plotë i Organizatës, Bordi Drejtues përcakton nëse kërkesa i plotëson kriteret, sipas nenit 17, pika 1 dhe i propozon Asamblesë së Përgjithshme pranimin ose jo të kërkesës. Asambleja e Përgjithshme merr vendim për pranimin ose refuzimin e kërkesës në fjalë. Personi i interesuar, së bashku me kërkesën me shkrim duhet të paraqesë edhe letra reference nga 2 anëtarë të Organizatës.

### **1.2 Të drejtat dhe detyrimet**

Ndër të drejtat dhe detyrat e Anëtarëve të Plotë të Organizatës janë:

- Të respektojnë dhe vëzhgojnë zbatimin e Kodit të Etikës;
- Të marrin pjesë në seancat dhe nëtakimet vendim-marrëse të Asamblesë së Përgjithshme;
- Të zgjedhin dhe të zgjidhen anëtarë të organeve drejtuese të Organizatës;
- Të marrin hapa për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, për ndryshime të neneve të Statutit ose për shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të Organizatës;
- Të propagandojnë aktivitetin e Organizatës;
- Të jenë pjesë e plotësimi të objektivave të Organizatës;
- Të marrin pjesë në mbledhjet dhe në aktivitetet e Organizatës;
- Të paguajnë rregullisht kuotat;
- Të hartojnë rregullisht raporte mbi aktivitetin e Organizatës dhe organeve të saj.

## **2. Anëtar Mbështetës**

Anëtarëmbështetës do të jenë personat që:



- Mbështesin dhe kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të Organizatës dhe qe mbështesin atë me punën e tyre vullnetare ose përmes ndihmës financiare;
  - Paguajnë kuotë;
- Anëtarët Mbështetës nuk kanë të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme.

### **3. Anëtar Nderi**

Të gjithë personat, shtetas të Republikës së Shqipërisë ose shtetas të huaj, që kanë merita të veçanta lidhur me Organizatën në fjalë, mund të bëhen Anëtarë Nderi të Organizatës.

- Anëtarët e Nderit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Bordit Drejtues;
- Anëtarët e Nderit nuk paguajnë kuotë.

Në Asamblenë e Përgjithshme kanë të drejtë vote vetëm ata Anëtarë Nderi që janë edhe Anëtarë të Plotë.

#### **3.1 Të drejtat dhe detyrimet**

Të drejtat dhe detyrimet e Anëtarëve të Nderit dhe atyre Mbështetës të Organizatës janë si më poshtë:

- Të respektojnë Kodin e Etikës;
- Të propagandojnë aktivitetet e Organizatës;
- Të jenë pjesë e plotesimit të objektivave të Organizatës;
- Të marrin pjesë në mbledhjet dhe konferencat e Organizatës;
- Të paguajnë rregullisht kuotat;
- Të hartojnë rregullisht raporte mbi aktivitetin e Organizatës dhe organizmave të saj.

## **NENI 18 PËRFUNDIMI I ANËTARËSISË**

Anëtarësia në Organizatë përfundon:

- Me dorëheqjen me shkrim nga anëtari;
- Me përjashtim nga lista e anëtarësisë për shkak të mospagimit të kontributit të anëtarësisë për më shumë se një vit;
- Me përjashtim nga anëtarësia për shkak të një dënimi të vlefshëm ligjor për akte kriminale si vjedhje, përvetësime dhe të ngjashme, kryerje aktivitetesh të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e Organizatës;
- Me vdekjen e anëtarit.

Bordi Drejtues i Organizatës propozon për përjashtimin nga lista e anëtarësisë, ndërsa Asambleja e Përgjithshme vendos për përjashtimin nga anëtarësia.



## **NENI 19 SHPËRNDARJA**

Shpërndarja e Organizatës bëhet me nismën e vetë ose me vendim të formës së prerë nga Gjykata kompetente.

Asambleja e Përgjithshme shqyrton kërkesën për shpërndarjen e Organizatës kur një gjë të tillë e kërkon Bordi Drejtues i saj, Presidentiose 1/3 (një e treta) e anëtarëve. Vendimi për shpërndarjen e Organizatës konsiderohet i vlefshëm kur votojnë pro shpërndarjes jo më pak se dy të tretat.

Kur vendoset shpërndarja e Organizatës, Asambleja e Përgjithshme emëron një apo më shumë likujduesë. Likujduesit veprojnë konform legjislacionit në fuqi për të kryer procedurat e likujdimit financiar dhe për të përcaktuar destinimin e pasurisë.

## **NENI 20 HYRJA NË FUQI E STATUTIT**

Ky statut hyn në fuqi nga momenti i regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Organizatës.